



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:019025
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05376791

KF.nr.485/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Radiotelevizioni i Kosovës RTK”, me numër fiskal 600294657 dhe seli në rr. “Xhemajl Prishtina”, nr.12 në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit të ATK-së nr.406/2020 të datës 18.12.2020, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 13.02.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse Shqipërim Spahiu dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur A.A., mori këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura në kontestin tregtar-administrativ sipas padisë së paditësit “Radiotelevizioni i Kosovës RTK”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Administratës Tatimore të Kosovës, për shkak se paditësi ka hequr dorë nga padia.

A r s y e t i m

Paditësi “Radiotelevizioni i Kosovës RTK”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi në gjykatë me datë 02.02.2021, për anulimin e vendimit të të paditurës me nr.406/2020 të datës 18.12.2020.

Me datë 13.02.2024 gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor publik në prani të përfaqësueseve të palëve ndërgjyqëse..

Përfaqësuesi i palës paditëse Shqipërim Spahiu, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në këtë fazë të shqyrtimit kryesor tërhiqen nga kërkesëpadia e dorëzuar përmes padisë, kjo për arsye se gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të padisë për anulimin të vendimit nr.406/2020 të datës 27.01.2021 Ministria e Financave ka nxjerr vendim nr.04/60 përmes të cilit edhe tani si palë paditëse kanë përfituar nga falja e ndëshkimeve dhe kanë konsideruar se nuk ekziston interesi juridik i paraparë në paragrafin 4 të nenit 2 të LPK-së, pa të cilin çdo vazhdim të këtij procesi nuk ka asnjë përfitim në këtë procedurë.

Përfaqësuesi i palës së paditur, A.A. në seancë deklaroi se meqë pala paditëse në seancën e sotme deklaroi që tërhiqet nga padia duke qenë se ka ndryshuar gjendja faktike nga momenti i paraqitjes së padisë, çështje e cila është paraqitur edhe në përgjigje në padi në par. 3 të kundërshtimit dhe këtë duke u mbështetur edhe në provën e nxjerrë nga sistemi elektronik i ATK-së nuk e kundërshtojmë sepse kjo është gjendje reale dhe kërkojmë nga kjo gjykatë e nderuar që të nxjerrë aktgjykim duke u bazuar në deklaratimet e palës paditëse.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 13.02.2024, ka nxjerr aktvendim për pezullimin e procedurës në këtë konflikt administrativ sipas padisë së paditësit, për shkak të heqjes dorë nga padia e palës paditëse.

Rrjedhimisht, konform nenit 31 par.1 , të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative. me të cilin përcaktohet se *“Paditësi mund të heq dorë nga padia derisa të mos merret vendimi”*, gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për ta pezulluar procedurën në këtë kontest tregtar administrativ.

Duke marr për bazë faktin se në këtë rast paditësi ka hequr dorë nga padia, gjykata nuk është lëshuar në vendosje sipas padisë.

Duke marr parasysh të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 31 par.1 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Numri i lëndës: 2021:019025
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05376791

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.485/22, datë 13.02.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.